



**VENDIM**

**Nr. 65 Date 22 .09. 2009**

**PËR**

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA  
NGA ERE SHOQËRISË HERA SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë HERA sh.p.k,

**Dhe duke konsideruar :**

Kompleksitetin e problemtikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencen teknike të huaj,

**Vendosi:**

1. Të shtyje me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi afatet e përcaktuara në pikën “1” dhe “4”, të Vendimit nr.61 datë 02.11.2007 “Për dhënien e Licensës për Ndërtim, Instalim dhe Shfrytëzim të Centraleve Elektrike me Erë si dhe Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Këto Centrale HERA sh.p.k (Projekti KAPPET)” të ndryshuar me vendimin nr.93 date 06.08.2008 “Për një ndryshim në vendimine Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.61, datë 02.11.2007 “Për dhënien e Licensës për Ndërtimin e Centraleve Elektrik me Ere dhe Prodhimin e Energjisë Elektrike”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIM**

***Nr. 65 Date 22 .09. 2009***

**PËR**

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA  
NGA ERE SHOQËRISË HERA SH.P.K**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____